



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe procesin e lustracionit”
2. Projektligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Mhill Fufi.

Mungojnë:

Tom Doshi, Petrit Vasili.

Të ftuar:

Erion Veliaj – ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

Gentjana Sula – zëvendësministre e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

Alfred Nurja - drejtor Kabineti në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

Renato Kalemi - këshilltar

Bilal Kola - drejtor i Institutit të ish-të Përndjekurve Politikë

Ermira Shtino - drejtore e Drejtorisë së Politikave për ish-të Përndjekurit Politikë.

Kledia Mazniku - drejtore e Shërbimeve Juridike

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, dhe si pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e nismës ligjore të projektligjit “Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe procesin e lustracionit”, iniciativë e paraqitur nga deputetët zonja Mesila Doda dhe zoti Shpëtim Idrizi. Të dy deputetët janë njoftuar për këtë mbledhje, për të qenë prezent dhe për të bërë paraqitjen e iniciuar prej tyre në Kuvendin e Shqipërisë, ashtu siç e kërkon edhe rregullorja e Kuvendit, që kanë të drejtë të paraqesin nisma ligjvënëse Këshilli i Ministrave, një ose më shumë deputetë ose mbi 50 mijë zgjedhës, një parashikim kushtetues. Zonja Doda dhe zoti Idrizi janë njoftuar, por nuk janë paraqitur për arsye që nuk dihen.

Pikë të dytë, kemi parashikuar propozimin e projektligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, iniciativë e Këshillit të Ministrave, të cilën do ta prezantojë ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, por duke llogaritur kohën e kisha njoftuar ministrin në orën 11:00.

Ndërkohë që ministri është këtu, mund të riçelim mbledhjen e komisionit.

Ju kërkoj ndjesë zoti ministër, pasi bashkë kishim rënë dakord që të paraqiteshit në orën 11:00, por duke qenë se pika e parë nuk u ezaurua do t’ju kërkoj mirëkuptimin për shpejtim të ardhjes suaj.

Po, zoti Bylykbashi, për procedurë!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar i komisionit! Sot në axhendën e këtij komisioni janë dy projektligje për një çështje shumë të rëndësishme, siç është dekomunistizimi i shoqërisë shqiptare dhe i shtetit shqiptar, i cili është një problem që, edhe pse kanë kaluar 25 vjet, nuk është mbyllur. Në fakt, kjo do të ishte një çështje e rendit të ditës sonë sikur puna të ishte normale. Sot nuk mund të ketë një punë normale në parlament sepse jemi përpara një fakti shumë të rëndë, që ka ndodhur dhe është bërë publik për gjithë opinionin shqiptar.

Kemi porosinë për të vrarë dy deputetë, që për fat të keq janë kolegë të këtij komisioni, dhe për fat të keq kjo porosi është bërë nga kreu i Kuvendit. Një gjë kaq e rëndë nuk do të mundet kurrë që të na mbyllë sytë dhe të veprojmë sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Partia Demokratike ka kërkuar zyrtarisht mocion për shkarkimin e kreut të Kuvendit. Është kërkuar dhe kanë filluar, sipas dijenisë sonë, edhe procedurat nga prokuroria për të hetuar këto akuza kaq të rënda, që nuk janë çfarëdo, por që janë të padëgjua deri më sot.

Kemi të bëjmë me një tentativë për vrasje të dy deputetëve dhe sigurisht një gjë kaq e rëndë nuk mund të hetohet kurrë kur personi, i cili akuzohet është numri dy i shtetit, është

në krye të institucionit tonë dhe për rrjedhojë nuk mund të ketë hetim të pavarur, të besueshëm në sytë e qytetarëve shqiptarë.

Sigurisht ky parlament nuk mund t'i shmanget një përgjegjësie kaq të madhe, pasi po flasim për një kërcënim, i cili sot prek dy deputetë të parlamentit shqiptar. Ndërkohë, tregon qartë akuzat që janë bërë dhe faktet që po dalin çdo ditë, tregon qartë se sa thellë ka shkuar e keqja, ajo që ne ngritëm me forcë gjatë kësaj periudhe, nevojën për dekriminalizimin e parlamentit dhe të administratës, dhe të gjitha faktet që ndodhën kanë bindur edhe Parlamentin Europian dhe ndërkombëtarët.

Sot, fronti për mbështetjen e dekriminalizimit të politikës dhe të parlamentit shqiptar, i maxhorancës, vjen me deklarata jashtëzakonisht të forta nga faktorët ndërkombëtarë, nga ambasada amerikane dhe Bashkimi Europian.

Nuk mund të mbyllem sytë dhe të pretendojnë që sot mund të merremi me çështje të tjera sikur nuk ka ndodhur asnjë gjë. Nuk mund të ndodhë kjo për sa kohë në krye të Kuvendit është personi, i cili akuzohet për tentativën për të vrarë dy deputetë. Nuk mund të ndodhë kjo nëse kreu i Kuvendit nuk shkon përpara drejtësisë të zbardhë të vërtetën atje. Ai nuk mund të hetohet me pushtet.

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, tani na thuaj cila është procedura?

Oerd Bylykbashi – Procedura është që kjo mbledhje nuk mund të vazhdojë të shqyrtojë çështje të tjera, sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Situata është e rëndë dhe ne kërkojmë që të diskutohet këtu, dhe parlamenti shqiptar të mos të funksionojë me procedurën normale, derisa kreu i Kuvendit të japë dorëheqjen ose të shkarkohet nga parlamenti. Për rrjedhojë, drejtësia të bëjë punën e saj e papenguar dhe e papresuar, përndryshe, çdo tentativë tjetër është përpjekje për të devijuar një nga çështjet më të rënda, që i ka ndodhur jo vetëm politikës shqiptare, por edhe këtij parlamenti.

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, ju po kërkon ta devijoni procedurën normale parlamentare për një akuzë, të cilën në rastin më të mirë është duke e shqyrtuar një organ kushtetues, siç është prokuroria, gjithashtu, në rastin më të keq ju jeni duke ushtruar një presion publik prokurorisë, institucionit të pavarur kushtetues me deklaratat tuaja politike.

Ju po flisni për një gjë hipotetike, ndërkohë që keni katër të vrarë në bulevard të pa hetuar dhe të papërfunduar. Në qoftë se quani një akuzë hipotetike gjakun e katër njerëzve dhe nuk e quani hall, ky nuk është halli im, por juaji, se ju keni halle të ndryshme për të bërë politikë. Megjithatë, unë ju dëgjova, pavarësisht se nuk është një gjë që përputhet me rendin e ditës, bëtë një deklaratë politike dhe për procedurë nuk mund të ndërpritet mbledhja e komisionit për një gjë të tillë, ndiqni rrugën procedurale për të gjitha akuzat tuaja politike.

Zoti Ristani, e ka fjalën.

Arben Ristani – Unë ju bëj thirrje si anëtar i këtij komisioni, që ta marrim seriozisht këtë problematikë që kemi, pasi jemi vërtet të shokuar dhe të stresuar. Unë kam dalë sot me frikë nga banesa, për të ardhur në këtë godinë, pasi dy kolegë të këtij komisioni, dy deputetë të nderuar, janë tentuar të vriten, sipas tyre nga Kryetari i Kuvendit dhe të vij në këto korridore ku shëtit i lirë një njeri që ka urdhëruar dy vrasje, të dy kolegëve tanë, më besoni, është e frikshme, është stresuese, është shokuese. Vrasës të tillë dhe njerëz të tillë na bëjnë të mendojmë që ndoshta edhe nën karriget tona mund të vendoset lëndë eksplozive....

Fatmir Xhafaj – Futi një kontroll edhe...

Arben Ristani – Po ky është problemi, pra ky vrasës i akuzuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ristani – Ky njeri i akuzuar që po tenton të vrasë dy kolegët tanë, dhe i kemi të dy kolegët tanë të kësaj tavoline, të këtij komisioni, janë dy kolegët tanë, më besoni jemi të shokuar dhe në pamundësi për të vazhduar punën, të bëjmë politikë, shëtit i lirë këtyre korridoreve. Kjo është një gjendje shokuese, stresuese, e cila nuk na lë të punojmë të qetë dhe të lirë.

Prandaj, nuk mund të kemi një zhvillim normal pa zgjidhur këtë problem. Ky njeri duhet të japë dorëheqjen, të shkojë përpara drejtësisë në mënyrë që edhe ne të jemi të qetë, se nuk kemi një vrasës që na vërtitet korridoreve, por kemi një njeri normal. Këtë duhet ta sqarojmë, këtë duhet ta sqarojë prokuroria në mënyrë që puna të zhvillohet...

(Diskutime pa mikrofon)

Ndërkohë, ky stres, ky shokim dhe kjo problematikë që kemi nuk na lënë të punojmë të lirë me një të akuzuar për dy vrasje, që vërtitet vërdallë këtyre korridoreve. Ky është problemi.

Fatmir Xhafaj – Zoti Braho, ka kërkuar fjalën!

Spartak Braho – Pa dyshim që muhabetet e sabahut të zotit Bylykbashi dhe Ristanit në mbledhjen e komisionit duhen vlerësuar seriozisht, veçanërisht që poshtë të ndenjurave mund të kenë edhe ndonjë kallëp dinamiti, por me këtë rast, meqë e hapën këtë bisedë, doja t'ju bëja një pyetje. Kush ju ka thënë juve që Ilir Meta do të vriste Iksin dhe Ypsilonin? Nga e keni marrë vesh? Bylykbashi i pari.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju nuk keni çfarë jepni, asnjë përgjigje, sepse...

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ristani - Kolegët tanë të këtij komisioni, vetë më pyete. Kolegët tanë të këtij komisioni, janë këtu, janë njerëzit tanë.

Spartak Braho - Kush ju ka thënë juve? Kush?

Arben Ristani - Kolegët tanë të këtij komisioni që akuzojnë Kryetarin e Kuvendit që ka dashur t'i vrasë, ka përgatitur tentativë për t'i vrarë.

Spartak Braho - Kush ju ka thënë juve? Kush? Zotëri, kush? Saliu e tha dje, por po e thoni edhe ju sot. Kush ju ka thënë juve?

Arben Ristani - Në këto kushte ne nuk jemi në gjendje....

(Diskutime pa mikrofon)

Spartak Braho - Keni kurajën ta thoni kush ju ka thënë juve?

Arben Ristani - Çfarë shqetësimi ke? Kryetari i Kuvendit të shkojë para drejtësisë pa imunitet....

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj - Ka imunitet.

Spartak Braho - Pse keni frikë ta thoni? Pse druheni ta thoni? Bëni tërë këto deklarata këtu dhe nuk thoni kush e ka thënë.

Arben Ristani - Kolegu ynë i komisionit na e ka thënë.

Spartak Braho - Cili?

Arben Ristani - Kolegu, zoti Doshi.

Spartak Braho - Atëherë, më dëgjoni mua me kujdes. Memeci foli, memeci ka folur dhe ka thënë që janë sajesa, mos u shpejtoni.

Për sa i përket merakut tuaj për kërkesën për

(Diskutime pa mikrofon)

... votëbesimin e zotit Meta, mos kini merak se do të trajtohet me shumë kujdes nesër. Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbylлим këtë diskutim.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk ka mundësi. Folët dy ju, një këtej, nuk ka më se çfarë flasim.

(Diskutime pa mikrofon)

Po lëre të flasë që t'i heqim frikën. Fol, se duam t'ua heqim frikën, të lutem, se duke folur çlirohen nga frika.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Halimi – Ka një shqetësim mbarë qytetar këtu dhe nuk ka nevojë të bëni as gallatë dhe as të evokoni të kaluarën. Ka një shqetësim publik. Njëri nga miqtë më të ngushtë të Kryeministrit, njëri nga dëshmitarët okularë të një ngjarjeje shumë të rëndë, të cilën të gjithë qytetarët e Tiranës e dinë, e ndodhur muaj më parë pak metra nga këtu, për fat të mirë pa viktima, një dëshmitar, i cili ka vendosur që të rrëfëhet para qytetarëve dhe para drejtësisë ka vendosur të rrëfëhet dhe të tregojë se ka pasur një tentativë për ekzekutim të dy deputetëve të këtij komisioni dhe ky komision duhet të mbajë qëndrim. O do t'u dalë në krah deputetëve, o do t'i dalë...

(Diskutime pa mikrofon)

Prokurorin e merrni dhe e thërrisni në zyrë si kurrë ndonjëherë, s'ka ndodhur ndonjëherë, kurrë nuk ka ndodhur ndonjëherë. Gjithsesi, kjo nuk është çështje që trajtohet, nuk më duhet fare ajo pjesë. Mua më duhet se kë thërret dhe kë ul ti.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë po ju them këtë gjë, që këtu dy deputetë, dhe ti si kryetar i këtij komisioni duhet që të mbash qëndrim, se dy deputetë...

Fatmir Xhafaj - Më thuaj.

Eduard Halimi - Dy deputetë të këtij komisioni janë dashur të ekzekutohen, është kërkuar që të ekzekutohen dhe ke një dëshmi nga një deputet.

Fatmir Xhafaj - Po, çfarë duhet të bëj?

Eduard Halimi - I cili thotë se ka një tentativë dhe ka pasur një tentativë, janë paguar para për t'u vrarë, dhe në këtë mes ne nuk mund të mbyllim sytë, në këtë mes, në këtë gjendje të rëndë që është nuk mund të ulim kokën, as të bëjmë gallatë, por është një ngjarje shumë e rëndë, një ngjarje që ky komision duhet të ndalet, të mbaj qëndrim një herë ky komision për këta dy deputetë të këtij komisioni, të këtij parlamenti dhe pastaj të vazhdohet me rendin e ditës. Çfarë rend dite do të vazhdojmë ne? Për çfarë do të vazhdojmë të flasim ne? Të vazhdojmë për krimet që kanë ndodhur para 100 vjetve, por ne kemi këtu krimin. Ne kemi një dëshmitar, i cili po tregon shokët e vet, po tregon dhe po denoncon miqtë e vet me ata të cilët ka ndarë deri dje pazarin. Sot, shoku tjetër i ngushtë i tij, thotë që më paska bërë shantazh. Për çfarë i ka bërë shantazh?

Fatmir Xhafaj – Cili është propozimi procedural? Ka mundësi të lutem.

Eduard Halimi – Propozimi i procedurës është të ndalohet rendi i ditës, të mbahet qëndrim për këtë ngjarje të rëndë.

Fatmir Xhafaj – Çfarë të bëj? Mos e ka Rregullorja. Si? Çfarë duhet të bëj?

Eduard Halimi – Të pyesësh deputetët që janë kërcënuar, të shqyrtohet paraprakisht kërkesa e bërë për mocionin e shkarkimit të Kryetarit të Kuvendit dhe pastaj të vazhdohet.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Edhe ju për procedurë. Urdhëro, zonja Caka!

(Diskutime pa mikrofon)

E kuptoj që jeni të shqetësuar për zotin Doshi ju, por fjalën e ka zonja Caka. Ka mundësi ta dëgjojmë?

Silva Caka – A mundem një sekondë, ju lutem!

Faleminderit, zoti kryetar!

Më duhet t’i them diçka edhe zotit Ristani.

Fatmir Xhafaj – Ja sa të kontrollojë pak te karrigia dhe do të kthehet.

Silva Caka – Zoti Ristani dhe zoti Bylykbashi,

Akuzat nuk fabrikohen dhe as nuk vërtetohen në Komisionin e Ligjeve. Akuzat janë bërë nga më të ndryshmet qoftë në qeverinë tuaj, një qeveri...

(Diskutime pa mikrofon)

Je jurist dhe e di shumë mirë që një qeveri apo një person nuk jep dorëheqjen për shkak të disa akuzave, të cilat janë ende të pavërtetuara. Do të doja vetëm t’ju kujtoja diçka, një fjalë të kryetarit tuaj të famshëm, i cili në Shkodër, përpara zgjedhjeve, ka thënë se zoti Rama ka cituar Hil Mosin dhe u ka servirur shqiptarëve Tom Doshin dhe fjalët e tij kanë qenë: “Do të çosh në parlament kryetrafikantin”, ndërkohë që Berisha Junior e ka quajtur një ordiner, i cili ka marrë fakultetin pa marrë ende shkollën e mesme. Berisha Junior thotë se zoti Doshi, kur bën akuza, vetëm mbllaçit, çka do të thotë që ju, nëse nuk e keni besuar atëherë, a mund të ma thuash, more zotëri, dhe akuzat kanë qenë për zotin Berisha dhe Berisha Juniorin, a mund të na thuash pse e besoni sot?

E dyta, kam përshtypje që problemi juaj me prokurorinë nuk është sesi do të jetë hetimi, problemi juaj do të jetë se ju nuk e quani dot zotin Llalla “lavire e bulevardit” siç quajtet Ina Ramën. Për mua mbaron këtu.

Fatmir Xhafaj – Zoti Strazimiri, urdhëroni!

Gent Strazimiri – Zoti kryetar,

Në këtë rast unë do të jem në krahun tuaj. Nuk ka një pikë të Rregullores, që të rregullojë këtë që po diskutojmë tani. Jemi të detyruar të jemi jashtë Rregullores ju dhe unë, të gjithë bashkë.

Rregullorja është një situatë krejtësisht jashtë Rregullores, për shkak se Rregullorja përcakton, ashtu sikurse Kushtetuta, paprekshmërinë e deputetit, gjë që është cenuar. Nga

paprekshmëria e deputetit fillon çdo nen që rrjedh pas këtij koncepti në Rregulloren e Kuvendit.

Po flasim për rënien e Rregullores së Kuvendit, për rënien e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe këtu nuk më duket se ka ndonjë gjë për t'u tallur askush. Besoj se kemi të gjithë arsyet në qoftë se ju personalisht dhe të gjithë kolegët që kam përballë, kanë qenë të sigurtë deri tani me zbardhjen e 21 janarit. Në qoftë se sot paskeni kuptuar që Tom Doshi është ky që thoni ju dhe jo ai që keni thënë deri dje...

Silva Caka – E keni thënë ju...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zonja Caka!

Gent Strazimiri – Tom Doshi mund të jetë... Që të kuptosh diçka...

Silva Caka – Jo ta kuptosh ti, jo unë.

Gent Strazimiri – Dakord. Megjithatë, dëgjo, sepse unë të dëgjova! Tom Doshi mund të jetë ai që thua ti, mund të jetë edhe ai që ka thënë Sali Berisha, mund të jetë më i ziu në këtë botë. Për këtë arsye nuk meriton t'i vihet tritol nga Kryetari i Kuvendit nën makinë. Mund të shkojë në burg... Një sekondë, sepse aty do të dal!

Tom Doshi u interesonte të gjithëve, përveç njerzillëkut, nëse e ke. Pavarësisht se ti thua që është njeri i keq, dënimi që duhet të marrë në bazë të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë është tjetër gjë. Ka të drejtën e një procesi të drejtë, të pyetet, të mbrohet nga shteti dhe pastaj, nëse del fajtor, të shkojë atje ku e kanë vendin të gjithë të tjerët, bashkë me ata që kanë porositur vrasjen. Por ti nuk thua këtë. Ti thua që t'ia lëmë prokurorisë dhe pastaj bëni një retorikë, për mua çnjerëzore, kur filloni dhe talleni ju me viktimat e 21 janarit.

Tom Doshi rastësisht ka dalë dhe ka thënë ndër fjalitë e tij të para se është dëshmitar i 21 janarit. Dika disa gjëra për 21 janarin dhe prokuroria nuk e ka pyetur kurrë. Në qoftë se doni, zbardheni 21 janarin ashtu siç duhet! Pra, duhet të jeni me ne sot këtu.

(Zoti Xhafaj flet pa mikrofon.)

Ndërkohë, tek ai komision hetimor mund të kishe ardhur edhe ti, por ti nuk erdhe.

Fatmir Xhafaj – Më thirr! Do të vij të të tregoj shkopinjtë e gomës...!

Gent Strazimiri – I kam parë në televizor! Hajde! Te ky proces që do të merret prokuroria, a mund të jem i qetë...

(Diskutime pa mikrofon.)

A mund të jetë i qetë sot opinionimi publik se po heton prokuroria këtë çështje? Në qoftë se i akuzuari të akuzuarit për këtë punë janë në pozita shtetërore që të thërrasin prokurorin e Përgjithshëm dhe t'i japin direktiva si duhet ta zgjidhë këtë çështje të akuzuarit, kjo sigurisht nuk mund të... Është Kryetari i Kuvendit, kryetari i partisë dhe Kryeministri.

Këta dy persona ka akuzuar ai person që duhet të ishte i ulur atje sot, kolegu yt. Dakord. Për më tepër sot morëm vesh edhe një rrethanë tjetër. Dikush këtu në këtë komision që të vetmen gjë që ka bërë gjithë jetën ka shkuar vetëm nëpër hetuesi dhe vetëm ka rrahur njerëz. Ky është ligji që sjell sot këtu, lustracioni. Ky na dika që ai tjetri, memec paska folur m'u duk si te filmi "Operacioni i zjarrit". Këta sikur kanë dalë nga filmat me sigurim, zotëri! Te ky proces duhet kemi besim ne?

Zoti Xhafaj, ngrijeni kokën! Ngrijeni kokën! Ti e kupton që këto janë probleme shumë të rënda! Sot bën sikur nuk ke frikë! E ke provuar ti vetë në kurriz këta dy vjet se çfarë do të thotë polici e këtyre horrave! Bëhu sot me ne! Bëhu sot me secilin prej atyre që nuk e meriton tritolin poshtë!

Fatmir Xhafaj – Vetëm me ju dhe me politikën...

Gent Strazimiri – Për sa u përket konsideratave që ju ndryshoni, ky zotëria që ka ardhur sot këtu, status i datës 11 janar 2011, pas "Fiksit", nuk e di se cila pjesë ma shpifi më shumë. Ndoshta fillimi, ku Ilir Meta pështyn gishtat obez, si kambist ordiner, dhe shfleton si të ishte shukë me lekë atë defterin ku në listë vijonin ARMO, HEC-i TEC-i, kryetarja e Gjykatës së Lartë, prokurorët, bakshishi, 700 mijë euro dhe reticencë. Pika kryesore: "Kam folur me Saliun, pastaj e ka me shkronja të mëdha kapitale:

Fatmir Xhafaj – Të lutem, ke gjë për procedurë? Edhe një herë?

Gent Strazimiri – Për procedurë, e cila nuk mundem dot... Thelbi i Rregullores ka rënë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Gent Strazimiri – Një deputet, një koleg yni, kam qenë zëvendësministër i Brendshëm dhe disa prej këtyre që folën e bën si trima, në telefonatën më të parë kërcënuese që kanë marrë ka shkuar e gjithë policia...Për të më garantuar sigurinë etj., etj., me radhë. Sot mos bëni si trima, sepse nuk ka trimëri. Kur të është qepur shteti paguan lekë të të vrasin, askush nuk është më i sigurt. As ti, zoti Xhafaj!

Fatmir Xhafaj – Dakord. Kjo ishte procedura juaj.

(Deputetët e opozitës largohen nga komisioni.)

Zoti Manja, urdhëroni!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Ndoshta kolegët e opozitës duhet të kishin pritur që të shpjegonim edhe ne disa gjëra për procedurë, por shfrytëzojmë rastin që janë mediet e pranishme të themi edhe ne dy fjalë për disa shqetësime që ngritën kolegët e opozitës.

Singerisht, unë prisja që kolegët e opozitës në respektim të marrëveshjes së 24 dhjetorit të vitit që kaloi, të bëheshin pjesë e një procesi shumë të rëndësishëm, që është procesi i dekomunistizimit dhe i dekriminalizimit, fakt, për të cilin u betohen shqiptarëve, nga mëngjesi deri në darkë, që si opozitë do të jemi për një demokraci të pastër dhe për funksionimin e një shteti ligjor, ku të sundojë ligji dhe barazia përpara ligjit. Mirëpo ajo që unë konstatova ishte fakti se kolegët e opozitës ishin të alarmuar, jo nga frika e Ristanit, që kishte frikë të shëtiste korridoreve të parlamentit, as nga frika për të qëndruar në karrige, as nga ky tjetri që foli në fund, por unë pashë se ata ishin të alarmuar nga frika që ka Sali Berisha nga projektligji që do të diskutojmë sot në këtë komision.

Personi i vetëm i alarmuar dhe që i kishte porositur ata qyqarët e vet deputetë të bëjnë zhurmuesin sot në këtë komision është vetëm një njeri, Sali Berisha. Ai ka frikë nga hapja e dosjeve, ai ka frikë që në këtë vend të punohet për shtetin ligjor dhe për sundimin e ligjit.

Unë në seancën e së enjtes që kaloi nuk dua të citoj Sali Berishën, sepse ai nuk di të citoj asgjë, por i lexon, tha: “Asnjë komb i lirë nuk e meriton krimin.” Iu referua një filozofi, se kështu u referohet ai. Po, “asnjë komb i lirë nuk e meriton krimin”, por është një fatkeqësi e madhe kombëtare që për 25 vjet një komb i lirë si Shqipëria është qeverisur nga njerëzit e antivlerave, nga njerëz të krimit, nga njerëz cinik, të ligj dhe të pamoralshëm dhe ky njeri sot po bën çorbë politikën shqiptare edhe pse është 70 vjeç dhe e di që i ka hyrë një rrugë pa kthim, sepse shqiptarët nuk mund të pranojnë më të qeverisen nga krimi.

Ndaj, kolegë të mi deputetë, ju ftoj që me shumë përgjegjësi dhe seriozitet të diskutojmë sot në parim një projektligj shumë të rëndësishëm, për të cilin një nga arsyet që jam bërë pjesë e politikës dhe e këtij parlamenti ka qenë kjo, të jap kontributin tim për një shoqëri të lirë dhe për një shoqëri ku të sundojë ligji. Me këtë projektligj që duhet t’ua kishim dhënë shqiptarëve para 20 e disa vjetësh, por ai që e ka penguar ardhjen në këtë parlament të këtij projektligji, është Sali Berisha.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja!

E mbyllim këtu pjesën e procedurës pa procedurë për të vazhduar me procedurën normale të komisionit. Nuk është faji ynë që kolegët u larguan. Është çështje përgjegjësie dhe përgjegjshmëri e tyre në raport me detyrën. Ne jemi në të drejtën tonë që të vazhdojmë sipas rendit të ditës.

Më vjen keq që dy kolegët e tjerë, që kanë paraqitur nismën tjetër, nuk janë paraqitur. Gjithsesi mbetet për t'u parë arsyeja nëse ka një arsye objektive apo jo për të proceduar më tej sipas Rregullores.

Ne nuk mund ta bëjmë parlamentin parti politike, as organizatë shoqërisë civile, as ekip futbolli. Ky është një institucion, institucioni më i rëndësishëm në vend, është institucioni ligjvënës. Ka rregulla, ka Kushtetutë dhe Rregullore. Ndaj jemi të detyruar ta respektojmë atë. Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Zoti Ministër, ju lutem një paraqitje të projektit që keni iniciuar ju dhe që ka sjellë qeveria për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Urdhëroni!

Erion Veliaj – Ju falënderoj, i nderuar kryetar, dhe ju, të nderuar kolegë, për mundësinë që të paraqes sot shkurtimisht së bashku me kolegët e mi projektligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i miratuar nga qeveria shqiptare në mbledhjen e fundit të muajit dhjetor të viti 2014. Do të kishte qenë dinjitoze që për një parti sot në opozitë, por që për 24, 25 vjet ka pasur kauzë të përndjekurit dekomunistizimin dhe hapjen e dosjeve të mos ishte ky rasti i sotëm ai i 25 vjetëve, ku gjithmonë i ka bërë bisht kësaj të vërtete, i ka bërë bisht këtij procesi, edhe pse mbi këtë proces është kërkuar të votohet dhe është kërkuar të përfaqësohet në këtë parlament. Por këtë nuk mund ta ndryshojmë, kështu që po vazhdoj, për të qenë sa më konciz në fjalën time.

Më lejoni të bëj një paraqitje të shkurtër të procesit që kemi ndërmarrë si Ministri e Mirëqenies në hartimin e këtij projektligji, të përmend shkurtimisht ekspertizën dhe praktikën ndërkombëtare mbi të cilën mbështetet ky projektligj dhe të ndalem edhe në tri elemente kryesore të përmbajtjes së këtij ligji. Siç edhe jeni në dijeni, në nëntor të vitit që shkoi, me porosi të Kryeministrit, si ministria që mbulon çështjet e ish-të përndjekurve politikë, u ngarkuam zyrtarisht nga qeveria me porosinë për të sjellë një platformë zyrtare diskutimi, një çështje që përndjek jetën tonë publike dhe institucionale prej më shumë se 20 vjetësh, që është përballja me trashëgiminë e ish-Sigurimit të Shtetit në vendin tonë.

Që në fillim, më lejoni të them se si i ri, i afrohëm kësaj çështjeje me shumë përulje, sepse flas si dikush që vetë nuk e ka përjetuar drejtpërdrejt kalvarin e vuajtjes komuniste, me vetëdije se bëhet fjalë për një nga çështjet më komplekse me të cilën është përballur vendi ynë gjatë dy dekadave të fundit, por edhe me kurajon që buron nga fakti se kjo qeveri nuk ka asnjë lloj kompleksi për t'u përballur qartazi dhe prerë me këtë term të rëndë për shoqërinë tonë.

Kjo vendosmëri e maxhorancës sonë qeverisëse, shpresoj shumë që do t'i bëjë bashkë të gjithë ata njerëz vullnetmirë, të cilët gjatë këtyre dy dekadave, pavarësisht përdorimit për përfitim politik të kësaj çështje, siç u pa edhe sot, ata që u larguan, kanë besuar sikurse edhe ne, që vetëm përballja me të vërtetën na mundëson konsolidimin e lirisë në vendin tonë, kanë punuar për të mbajtur gjallë kujtimin e të gjithë atyre që u bënë subjekt i persekutimit, nga më të egrit në histori, dhe kanë vazhduar pareshtur përpjekjet për të mbajtur aktual këtë debat.

Në këtë vend ne mund të mos biem dakord për shumë gjera, por besoj se të gjithë bashkohemi në të pranuarit se përgjatë dy dekadave, pavarësisht përpjekjeve sporadike të ndërmarra zakonisht, duhet ta pranojmë, vinë për përfitim politik apo elektoral, shoqëria shqiptare si e tërë, ka dështuar të përballët prerazi dhe të njohë të vërtetat e diktaturës komuniste në vend. 25 vjet pas rënies së komunizmit, Shqipëria mbetet i vetmi vend, fatkeqësisht ende në krah të Rusisë, megjithëse është një vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian, që nuk ka kryer transparencën e trashëgimisë së ish-Sigurimit të Shtetit. Ende sot e kësaj dite asnjë i persekutuar në këtë vend, i djathtë apo i majtë, komunist apo nacionalist, të cilët në mënyrë ironike u bënë njësoj viktime të dhunës së paprecedentë, nuk e dinë se çfarë kurdisi ky Shërbim kundër tyre.

Sigurisht që nuk jam këtu për të analizuar arsyet se pse ky proces nuk është ndërmarrë deri më sot, por besoj se më e pakta është se të gjithë mund të biem dakord që ky dështim tregon mungesë kurajoje për t'u përballur me të vërtetën e hidhur që na mban ende të lidhur me të shkuarën tonë. Duke kuptuar shumë mirë kompleksitetin e kësaj çështjeje, së bashku me grupin e punës të ngritur pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kemi qenë të vendosur të përfitojmë nga eksperiencia më e mirë europiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë, për të siguruar respektimin e një të drejte themelore: të drejtën e çdo viktime të diktaturës për të njohur të vërtetën, për të hetuar dhe njohur çdo aspekt të dhunimit, të cilat mbeten ende të mbuluara nga fshehtësia arkivore që mbulon ende veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit.

Në sigurimin e kësaj të drejte kemi arritur në përfundimin se eksperiencia gjermane përbën padyshim shembullin më të mirë europian në përballjen me të shkuarën e diktaturës. Më vjen mirë që ky qëndrim ndahet edhe nga përfaqësues të tjerë të politikës dhe të shoqërisë civile. Kemi arritur në këtë përfundim jo vetëm për shkak të marrëdhënies së ngushtë dhe ndihmës së pakursyer që qeveria gjermane ka afruar gjatë gjithë këtyre dekadave, edhe në përballjen me këtë çështje në vend, por mbi të gjitha për shkak të modelit që Gjermania ka vendosur në Europë dhe më gjerë në trajtimin e së shkuarës.

Gjermania përbën shembullin unik në Europë që ka ndërmarrë një përballje të thellë dhe shumëdimensionale me të shkuarën, një herë në vitet e pasluftës së Dytë Botërore në përballjen me të shkuarën naziste të vendit dhe për herë të dytë në përballje me të shkuarën komuniste të Gjermanisë Lindore dhe një prej shërbimeve sekrete më të urryera në botë, të STAS-it. Modeli i vendosur nga Komisioni Federal Gjerman për arkivat e STAS-it, i quajtur ndryshe Komisioneri GAUCK, që mban emrin e Presidentit aktual të Gjermanisë, është ndjekur nga afër në hartimin e projektligjit nga grupi i punës, i ngritur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Për ndihmën e dhënë për njohjen nga afër të kësaj eksperience, dëshiroj të falënderoj në mënyrë të veçantë qeverinë gjermane; sekretarin gjerman të shtetit, zotin Jorga Asmussen; ambasadoren Hofman këtu në Tiranë, për mbështetjet e dhënë grupit të punës në marrjen dhe kontekstualizimin e kësaj eksperience në Shqipëri dhe mbështetjen publike të këtij procesi.

Dua të falënderoj gjithashtu, në mënyrë të veçantë ish-nënkryetaren e parlamentit gjerman, zonjën Petra Blass, e cila punoi ngushtë për rreth një vit me grupin e punës në hartimin e këtij projektligji.

Dua të falënderoj gjithashtu, prezencën e OSBE-së në Tiranë dhe miqtë strategjikë të Shqipërisë për vlerësimin e bërë të projektligjit në fjalë, duke garantuar në çdo rast respektimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, por edhe mbrojtjen e parimeve kushtetuese në ndërmarrjen e këtij procesi.

Krahas kësaj përvoje, grupi i punës ka vlerësuar me kujdes të gjithë trashëgiminë e akteve ligjore të mbetura në fuqi, apo të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese e vendit tonë ndër vite, të ndërmarra si pjesë e procesit të pastërtisë së figurave.

Kemi vlerësuar në mënyrë të veçantë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, të datës 23 mars 2010, si edhe opinionin shterues të Kominisonit të Venecias të datës 13 tetor 2009 përpara se të inkorporonim këtë ligj.

Më lejoni të ndalem tani shkurtimisht tek tri elementet kryesore të projektligjit të paraqitur nga qeveria për miratim në Kuvend duke i besuar kolegëve të mi ndaljen më në hollësi në detajet teknike të projektligjit. Projektligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” ka për qëllim të sigurojë:

Së pari: aksesin në dosjet e ish-Sigurimit duke e konsideruar aktivitetin e ish-Sigurimit të Shtetit si aktivitet të një instrumenti të diktaturës, që ndryshe nga simotrat e saj në ish-vendet e Europës Lindore, ka operuar gjatë gjithë historisë mbi 40-vjeçar të funksionimit të saj në mënyrë të paligjshme si një platformë politike. Projektligji synon

dhënien e aksesit në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit sipas një procesi të mirërregulluar për të gjithë personat e prekur drejtpërdrejtë nga veprimtaria e ish-Sigurimit të Shtetit. Këtu përfshihen jo vetëm personat e përndjekur nga ish-Sigurimi, por edhe vetë bashkëpunëtorët dhe ish-punonjësit e Sigurimit, të cilët në përputhje me dispozitat e këtij projektligji, do të kenë të drejtën e aksesit të plotë në të gjithë informacionin e grumbulluar kundër tyre apo prej tyre gjatë viteve të veprimtarisë së Sigurimit. Për të gjithë trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të personave të prekur nga veprimtaria e ish-Sigurimit të Shtetit, projektligji siguron akses në informacion, në bazë të kritereve të mirëpërcaktuara, me qëllim vendosjen në vend të të drejtave të personave që nuk jetojnë më, përfshirë të drejtën për të siguruar rehabilitimin dhe ruajtjen e të drejtave të personalitetit të të vdekurve apo të të zhdukurve. Akses do të mund të sigurojë gjithashtu, për efekt të veprimtarive hulumtuese, kërkimore, akademike apo historike, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo vlerësimit të figurës dhe rolit të personave historikë të kohës, për aq kohë sa ky informacion i shërben këtij qëllimi të deklaruar.

Pika e dytë: informimi i institucioneve publike mbi marrëdhëniet që një person, i cili do të promovohet apo do të emërohet në një pozicion të lartë shtetëror kushtetues apo publik, ka pasur me ish-Sigurimin e Shtetit, në rast se kërkohet prej tyre në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2010 dhe sigurisht me opinionin e Komisionit të Venecias. Në lidhje me këtë pikë, më lejoni të theksoj edhe një herë bindjen e grupit të punës, që dispozitat e propozuara në këtë projektligj u përmbahen në mënyrë të saktë përcaktimeve rigoroze në lidhje me procesin e pastërtisë së figurave të cilat përcaktojnë këto burime që përmenda.

Kjo transparencë nënkupton gjithashtu përgjegjësinë që çdo person që kërkon post publik në vend, të bëjë të qartë publikisht asocimin e tij me të shkuarën e ish-Sigurimit përmes një procesi, i cili ka në thelb jo ndëshkimin përmes përjashtimit nga aksesit për të konkurruar, por detyrimin që t'u japë besim institucioneve tona përmes transparencës përpara të gjithë votuesve apo strukturave politike që bëjnë këto emërime. Çdo nismë tjetër, që do të shkonte përtej këtyre përcaktimeve, do të përbënte thjesht një spekulim politik si nisma të tjera që kemi dëgjuar kohët e fundit.

Më lejoni edhe për këtë që të shpreh qartë vullnetin e plotë të qeverisë për të ruajtur integritetin e procesit të hapjes së dosjeve larg çdo minimi me elemente antikushtetues ilustrative.

Pika e tretë: vënia në administrim të autoritetit të të gjitha dokumenteve të prodhuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, duke krijuar kështu një arkivë të re, të përqëndruar të të gjithë

dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit që, përtej qëllimeve të aksesit në informacion, do të mund t'u shërbejë edhe qëllimeve të kujtesës.

Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e të gjithë kësaj çështjeje dhe këshillave të miqve tanë ndërkombëtarë të dhëna gjatë procesit të konsultimeve të nismës, qeveria ka propozuar ngritjen e një autoriteti profesional dhe jashtë politikës për të siguruar menaxhimin me integritet të procesit, kompleks administrimit, përpunimit, por edhe informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit. Duke shënuar një kapërcim të të gjitha eksperiencave të mëparshme në këtë fushë, të cilat kanë vënë në dyshim të vërtetën e procesit të transparencës dhe pastrimit të figurave, qeveria është e vendosur që të hapë një kapitull të ri në këtë çështje, duke ndjekur praktikën gjermane të vendosjes nën administrim të plotë të autoritetit të ngritur për përmbushjen e qëllimit të këtij projektligji, të të gjithë lëndës arkivore të prodhuar nga ish-Sigurimi i Shtetit, pavarësisht se ku gjendet ajo e ruajtur aktualisht.

Vendosja nën administrimin e autoritetit të kësaj arkive do të mund të japë garanci të nevojshme për integritetin e procesit të ndërmarrë dhe mbylljen një herë e përgjithmonë të mundësisë së përdorimit të këtij materiali arkivor për shantazh politik apo të një natyre tjetër, siç ka ndodhur rëndom në iniciativa të tjera dhe qeveri të tjera që kanë propozuar ligje lustracioni.

Ngritja e një institucioni të tillë në Shqipëri behet i domosdoshëm edhe për shkak të faktit, se sipas informacionit paraprak, që mbi 14 mijë dosje apo 1,5 milionë fletë dokumente të ruajtura në arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe mijërave dosjeve të tjera në ruajtje në institucione të tjera shtetërore, si Shërbimi Informativ, nevojiten t'i nënshtrohen një procesi të plotë unifikimi, ruajtje dhe procesimi që përfiton nga eksperiencia më e mirë ndërkombëtare dhe qëndron larg çdo amatorizmi apo shkeljes së ligjit në administrimin e tyre, në raste që tashmë janë bërë edhe publike.

Duke ju falënderuar me gjithë zemër për vëmendjen, së bashku me grupin e punës së Ministrisë së Mirëqenies Sociale, mbetemi në dispozicion të këtij komisioni të nderuar për çdo informacion dhe shpjegim të mëtejshëm!

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Ministër, për ekspozenë tuaj shumë të plotë, dhe besoj shumë të qartë për qëllimin dhe konceptin tuaj lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji!

Dëshiroj t'ju bëj, gjithashtu, me dije se së bashku me ministrin është edhe ekipi i ministrisë. Nuk arrita ta bëj në fillim këtë prezantim për shkak të procedurës pa procedurë që u zhvillua. Të pranishëm së bashku me ministrin janë: Zonja Gentiana Sula,

zëvendësministre, zoti Alfred Nurja, drejtor i kabinetit të ministrit, zoti Bilal Kola, drejtor i Institutit të ish- të Përndjekurve Politikë dhe kolegu ynë si jurist. Dhe zonja Kledia Mazniku, drejtore e Shërbimeve Juridike.

Do të vazhdojmë me pyetje para se t'u jap fjalën kolegëve për pyetje, sqarime, në kushtet që u krijuan për të qenë transparent edhe me median, edhe me të gjithë ata që e ndjekin këtë proces këtu, por që dëshirojnë të dinë më shumë për fatin e mëtejshëm të tij. Në javën që vjen do ta rimarrim dhe një herë, do t'u japim mundësinë dy kolegëve të tjerë të jenë prezente, nëse do të jetë e mundur një gjë e tillë. Pastaj, duke qenë se ne jemi komision përgjegjës do ta ndërpresim këtu diskutimin dhe do të presim komisionet e tjera, që janë komisione për dhënie mendimi, për të dhënë opinionin e tyre lidhur me përmbajtjen e projektit.

Përfitoj nga rasti të falënderoj prezencën e OSBE –së për gatishmërinë që ka treguar si dhe shumë herë të tjera për të dhënë opinionin e saj për projektligje shumë të diskutueshme, shumë të debatueshme dhe me rëndësi për jetën politike sociale dhe ekonomike në vend, ashtu si dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile që kanë treguar disponibilitetin e tyre për t'u përfshirë në mënyrë aktive dhe për të kontribuar në këtë proces. Por, proceduralisht do të veprojmë në këtë mënyrë. Do të mbarojmë me pyetjet sot dhe do ta ndërpresim për t'i dhënë mundësinë dy ose tre komisioneve të tjera, nuk jam shumë i saktë kush e ka për dhënie mendimi. Më pas do të merremi me trajtimin, diskutimin, vlerësimin e opinionëve që kanë dhënë komisionet e tjera dhe natyrisht edhe të institucioneve të tjera të cilat u jemi drejtuar për të dhënë komentet përkatëse.

Kush ka pyetje? Po, zoti Subashi.

Armando Subashi - Faleminderit!

Doja fillimisht të falënderoja ministrin për prezantimin e draftit të këtij projektligji. Sigurisht që është një ligj shumë i rëndësishëm. Me thënë të drejtën kisha përgatitur një sërë pyetjesh, por nga shpjegimet që bëri ministri këtu, për disa prej tyre e mora përgjigjen. Por gjëja më e diskutueshme në gjithë këtë histori, sa herë që është hapur ky debat dhe sa herë janë miratuar dhe diskutuar këto ligje, pa dyshim që gjëja më sensitive është ajo që ka të bëjë me efektet që do të sjellë ky ligj në pastërtinë e figurave publike, duke filluar nga ato më të larta dhe deri tek punonjësit më të zakonshëm të administratës. Unë jam dakord me atë që tha ministri që ky ligj ka bërë kujdes për të respektuar maksimalisht përvojën e kaluar, ato çka kanë pasqyruar ligjet e kaluara edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, edhe opinionin e Komisionit të Venecias. Por gjithsesi do të doja që të merrja një përgjigje pak më të detajuar lidhur me këtë moment, sepse pa dyshim që është një moment shumë i rëndësishëm, jo vetëm

nga mënyra se si do të trajtohet, por sigurisht që ka potencialisht rrezikun e implikimeve kushtetuese brenda për një sërë parimesh që Kushtetuta sanksionon në këtë drejtim, por edhe për ta bërë më të plotë, më të qartë jo vetëm para komisionit, por ndoshta edhe për opinionin publik.

Pyetja ime është kjo: Deri ku shkon ky ligj në raport me gjithë funksionarët shtetërorë? Pra, po të kemi parasysh që këtu mund të kemi dy kategori, ata që janë në detyrë momentalisht, pra që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit vazhdojnë të kryejnë një detyrë kushtetuese ose ligjore dhe sigurisht pastaj edhe për pjesën tjetër, të atyre në vijimësi, pra për sa kohë që ky ligj do të vazhdojë të jetë në fuqi, do të kërkojnë të marrin mandate qoftë kushtetuese, qoftë mandate që vijnë nga zgjedhjet, qoftë edhe pjesa tjetër që do të shërbejnë në administratën publike, qoftë në bazë të ligjit për statusin e nëpunësit civil, apo në bazë të ligjeve të tjera, pra, çfarë parashikon ky ligj në raport me të gjitha këto kategori?

Pyetja e dytë, që përsëri do të doja të bëhej një shpjegim pak më i detajuar, ka të bëjë në fakt me afatin kohor të shtrirjes së këtij ligji. Është edhe një moment që është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese. Nëse ky ligj do të hyjë në fuqi në një datë të caktuar, shumë shpejt për disa javë, dhe pa dyshim që do të vazhdojë të shtrijë efektet e tij për një periudhë të caktuar, a ka parashikuar ligji ndonjë afat në këtë drejtim? Nëse jo a mendoni që duhet një afat i tillë, apo ky ligj do të veprojë pambarimisht në vite në këtë drejtim?

Kam dhe një pyetje tjetër për të cilën ndoshta ministri dhe stafi vetë mund të mos kenë dijeni të plotë, por mbase në gjithë këto vite është abuzuar mjaft me dokumentet e Sigurimit të Shtetit me arkivën që ekziston pranë Ministrisë së Brendshme. Si mendoni a ka qenë i plotë kuadri ligjor në drejtim të ruajtjes së këtyre dokumenteve? Ky kuadër ligjor a ka lejuar në gjithë këto vite abuzimi me to? A mund të jenë shfrytëzuar për qëllime të caktuara të gjitha dosjet e Sigurimit të Shtetit? Në këtë drejtim ligji i ri që ju keni paraqitur, pak a shumë ato nene, mendoni se e zgjidhin pas këtij momenti këtë problem?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Subashi!

Kush do të përgjigjet? Po, zoti ministër.

Erjon Veliaj – Ndoshta jap një përgjigje më politike dhe pastaj, për përgjigjen teknike mund të më ndihmojnë dhe kolegët.

Për çështjen e parë duhet të dallojmë shumë qartë se ky nuk është një ligj lustracioni dhe nuk ka asnjë arsye pse të kemi një kompleks për këtë, sepse kemi marrë një model që thamë ka funksionuar, modeli gjerman. Një nga televizionet e rëndësishme në vend kishte një dokumentar në detaje për të ndihmuar edhe ligjvënësin, por për të ndihmuar edhe

opinionin publik për të bërë dallimin. Sepse për një kohë të gjatë u abuzua, ku secili po i vinte një etiketë ndërkombëtare një propozimi dhe u pa fare qartë se modeli gjerman është modeli që ka propozuar qeveria. Nuk është një model hakmarrjeje, nuk është një model dënimesh kolektive, spastrimesh, apo gjëra të kësaj natyre. Aty ku kemi pasur dallimin kryesor ka qenë në faktin që alternativa tjetër që na është ofruar nga opozita na është dukur një alternativë me dashje antikushtetuese.

Pra, mënyra më e sigurt për të sabotuar një ligj të tillë është ta mbushësh me elemente antikushtetuese që mos ta kalojë fare filtrin e Gjykatës Kushtetuese, të dhunojë çdo vendim tjetër si të Gjykatës Kushtetuese apo opinionin e Venecias, të dalësh në publik si populist për të thënë se kjo është kauza morale e të djathtës dhe me të vërtetë ndodhi ajo që ndodh sot. E djathta nuk është interesuar fare as për të përndjekurit, as ka qenë për kështet, as për ligjin e hapjes së dosjeve. Dhe gjithmonë bën propozime dhe fut elemente antikushtetuese me garancinë që publiku do t'i shesë si një arritje të madhe këto ide, por me garancinë e plotë që, duke qenë antikushtetuese, këto ide nuk do të implementohen kurrë, sepse ligjet antikushtetuese nuk implementohen kurrë.

Ndaj që në strategji i kemi nisjet e kundërta. I kemi qëndruar besnik këtij modeli gjerman, këtij modeli të transparencës. Nëse dikush tjetër duhet të vijë me një ligj tjetër për lustracionin nuk ka nevojë të nakatosë dhe të prishë ligjin e transparencës me ide të kësaj natyre që Gjykata Kushtetuese i ka rrëzuar. Ndaj dhe ky është një ligj ekskluziv transparence. Nëse ka një element tipik lustracioni është vetëm në zgjedhjen e komisionerëve. Pesë komisionerët sigurisht që nuk duhet të kenë asnjë lidhje me të kaluarën, me Sigurimin e Shtetit, sepse duhet të jenë garantët apolitikë të këtij procesi, të këtij autoriteti të ri, por Kushtetuta e Shqipërisë nuk i ndalon askujt të drejtën të zgjidhet, zgjedhë, të punojë, të ndërrojë vendin e punës dhe gjëra të kësaj natyre.

Kështu që bëhet fjalë për një ligj të transparencës dhe jo një ligj të dënimeve kolektive, çka do të sillte rrëzimin e menjëhershëm të këtij ligji. Sigurisht ka një limit edhe procesi i transparencës. Limiti për informimin e institucioneve është 5 vjet, që është parashikuar në këtë proces. Institucionet kanë të drejtë të informohen. Ju kujtoj që edhe pa këtë ligj ne kemi pasur një kandidat për president, i cili rezultoi nga vetë partia që e propozoi bashkëpunëtor i Sigurimit. Nuk kishte ligje atëherë për lustracionin që ia ndalonin, por në bazë të këtij informacioni ajo parti hoqi atë kandidaturë, solli një kandidaturë tjetër. Pra, ne në Shqipëri kemi pasur raste të pastrimit të figurave edhe pa pasur ligje të tilla. Kështu që, në qoftë se në diskrecionin e institucioneve që pyesin për një propozim kushtetues, për një promovim të një figure të caktuar, detyra e autoritetit është ta informojë institucionin që pyet.

Dhe pastaj ashtu, mot a mot, si në Gjermani, autoriteti informon institucionin. Institucioni, Presidenti, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, prokurori, mbi këtë informacion duhet të përdorin logjikën e tyre dhe duhet të përdorin sensin e tyre të etikës e të jetës publike, për të vendosur mbi promovimin ose jo të figurave publike.

Dhe, e fundit fare, te pasojat e tjera që mund të ketë ligji, nuk ka ende sot një rast të vetëm, që të përndjekurit politikë të kenë ushtruar hakmarrje, të kenë pasur konfrontime fizike apo të ketë pasur dhunë ndër shumë raste që tashmë janë zbuluar.

Kemi pasur klerikë që kanë bërë ndoshta nga gjestet me sublime dhe më emocionuese për publikun, kur jo vetëm kanë falur në një proces vëllazërie ata që i kanë përndjekur, por kanë kontribuar në mënyrë aktive për pajtimin e shoqërisë. Ndaj, për sa kemi evidencë, transparenca ka sjellë pajtim dhe mësim për shoqërinë. Gjykoj se, sa më shumë transparenca që të kemi, do të jetë në mënyrë simbolike e thënë, më shumë libra si ato të At Zef Pllumit, nga të cilat ne njohëm atë periudhë të ferrit komunist, nga dokumentacione që do të na tregojnë më shumë se çfarë ne si shqiptarë i bëmë njëri-tjetrit. Gjithashtu, për një efekt didaktik, për një brez të ri, sot po votojmë për herë të parë njerëz që kanë lindur pas komunizmit, të cilëve të gjitha këto u duken si përralla nga e kaluara. Por, ashtu siç ndodhi në Gjermani, ku dekomunistizimi dhe denazifikimi sollën një komb më të mirë, një shoqëri më të hapur, një sistem demokratik më të pastër e më konkurrues.

Unë besoj se ky ligj do të ketë këto efekte në shoqërinë tonë. Kushdo tjetër që do të bëjë lojëra politike, sepse opozita është e mbushur me personazhe të dyshimtë dhe duan të pastrojnë partinë e tyre nga këto probleme, ai është problemi i tyre, nuk është problemi i kombit tonë. Dhe ajo që dëgjoj shpesh është se, faktorë të opozitës mundohen ta shtyjnë këtë agjendë për të larë hesapet brenda partisë së tyre. Unë gjykoj se problemet brenda një partie nuk janë problem kombëtar dhe, nëse kanë probleme të tilla, le t'i zgjidhin brenda partisë së tyre. Nuk gjykoj se duhet të ketë ankth i gjithë kombi ynë për rtë futur në ligje agjendat, siç kanë qenë më përpara ligjet, kur bëhej një ligj i caktuar për të hequr filan gjyqtar ose filan prokuror, që ishin qartas antikushtetuese.

Për dy-tri aspekte teknike, do të doja t'i jepja shumë shkurt fjalën Bilalit.

Bilal Kola – Më lejoni që, teknikisht, thjesht të përforcoj atë që parashtroi Ministri, sa i përket nenit 28 të ligjit. Pikënisja, sigurisht që ka qenë vendim i Gjykatës Kushtetuese, kur vjen çështja e pastërtisë së figurës, por gjithsesi, aspekti kryesor dhe aty ku ky ligj limitohet, është thjesht transparenca. Pra, nuk ka asnjë element neni 28, që një autoritet vendimmarrës, në rastin e rikandidimit apo kandidimit rishtazi të një kandidati, duke qenë se do të vihet në dispozicion të informacionit të marrë nga autoriteti që do të administrojë dosjet,

te lë themi të kushtëzohet emërimin apo zgjedhjen e këtij kandidati, bazuar në nenin 28. Kështu që, thjeshtë është elementi i transparencës. Pra, bëhet transparent ndonjë fakt, që e lidh kandidatin me të shkuarën e ish-sigurimit, dhe këtu limitohet gjithçka.

Pra, pastaj është diskrecioni i autoritetit, për të vendosur nëse do të emërohet apo zgjidhet një kandidat në rastin e një lidhje me ish-sigurimin.

Sa i përket pyetjes suaj të fundit, dëshiroj të theksoj faktin se, pikërisht neni 1 i ligjit, por edhe më pas në vijueshmëri, bëhet një kohezion dhe, le të themi, një harmoni, sa i përket legjislacionit, kur vjen puna tek administrimi dhe ruajtja e të dhënave personale, si dhe elementët që kanë të bëjnë me ruajtjen e sekretit shtetëror. Gjithmonë, edhe në këtë ligj, merr përparësi ruajtja e të dhënave personale, dhe sigurisht, merr gjithmonë përparësi absolute sekreti shtetëror.

Po jua ilustruj vetëm me një fakt këtë që thashë. Le të themi, në rastin kur një media e caktuar apo akademia, dëshiron të hulumtojë lidhur me raste të së kaluarës së një individi, qoftë ky me rol kryesor apo me rol të caktuar në historinë e ish-sigurimit të shtetit.

Në raste të tilla, gjithçka që ka të bëjë me atë që mund të quhej një informacion konfidencial, pra me të prekurit, me ata persona që kanë vuajtur dhunën e sigurimit apo ata të cilët ligji i konsideron si palë të treta, prej të cilëve siguri ka mbledhur informacione, kur vjen puna te të dhënat e tyre personale, asgjë nuk mund të dalë në publik. Pra, ajo që publiku shikon, në bazë të këtij ligji, janë elementë përgjithësues, që kanë si karakter hulumtimin sa u përket praktikave, por jo nominalisht personave që kanë pasur të shkuar me sigurimin.

Kështu që, gjykoj se ka një harmonizim dhe kohezion kur vjen puna te statusi i ligjeve që administrojnë qoftë të dhënat personale apo sekretin shtetëror. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Pyetje të tjera?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Jam shumë i bindur se ministri, me elokuencën e vet bëri një trajtim të gjithë projektligjit, jam i bindur se e ka lexuar, trajtuar dhe ligjin e dy kolegëve tanë, që kanë sjellë si nismë në parlament. Megjithatë, do të doja të di nëse mund t'i shkrijmë këto dy ligje? A kemi mundësi që ne të bëjmë, si të thuash, një ndërthurje të një projektligji, përveç atyre që thatë ju – gjë për të cilën ju falënderoj paraprakisht?

E dyta, e dëgjova me vëmendje ministrin dhe më duhet të them se ligjin, siç e tha ministri, ne nuk e bëjmë për parti të veçanta, por e bëjmë për kombin, e bëjmë për ne, për të gjithë ne. Tani unë do t'i them ministrit – se dikur edhe unë, edhe ministri, kemi folur në shumë fushata e debate televizive dhe kemi thënë se partitë janë një pasuri kombëtare. Duke

qenë partitë pasuri kombëtare, sepse prej tyre rrjedh demokracia dhe rrjedhin pastaj të gjitha institucionet, në bazë të votimeve që bëhen, pse të mos e ndihmojmë këtë pasuri kombëtare, pra partitë në tërësi, sepse nuk e kam për asnjë parti të veçantë, e kam në tërësi, e kam për partitë si pasuri kombëtare; pse mos t'i ndihmojmë duke bërë një ligj të tillë, që me të vërtetë, edhe ato të jenë të çliruara nga shumë elementë dhe shumë njerëz, që u zënë frymën partive të ndryshme, sepse shumë njerëz vijnë në krye të partisë, janë diku aty dhe nuk lejojnë mundësinë e njerëzve të tjerë apo gjeneratave të reja për të ecur përpara dhe për të konkurruar politikisht? Kjo është pyetja që kam unë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ministër.

Erion Veliaj – Përgjigjja e shkurtër për pyetjen e parë, nëse mund t'i shkrijmë të dy ligjet, është jo. Përgjigjja e gjatë, se përse jo, këtu nuk bëhet fjalë për të shartuar mollë me portokall. Këtu bëhet fjalë për të shartuar një proces ligjor që respekton Kushtetutën, me një proces amator antikushtetues. Kjo do të thotë se, sikur edhe një element i ligjit tjetër të futej këtu, do ta bënte “o je, o s'je shtatzënë”. Nuk mund të jesh pak shtatzënë, kështu që, ta lësh me barrë këtë ligj me elemente antikushtetuese, do të thotë ta sabotosh. Kështu që në këtë sens, futja qoftë edhe një elementi të lustracionit për të cilin gjykata është shprehur, disa kategorizime komplet amatore, që nuk janë të sigurimit të shtetit, por kanë të bëjnë me partinë që qeveriste Shqipërinë në atë kohë, që është komplet subjekt tjetër dhe objekt tjetër ligjesh. Na është dukur një proces i bërë me ngut, një proces që nuk ka respektuar asnjë kod e asnjë normë, që nuk ka një model, njëri është i shoqërisë civile, njëri është gjerman, njëri është çek, pra, një punë jo vetëm amatore, por absolutisht me elementë antikushtetues, që do ta minonin gjithë këtë situatë.

Unë e kuptoj agjendën. Në fakt, dua të them e mirëkuptoj agjendën. Ka një zell në disa elementë gjenuinë të së djathtës shqiptare, të opozitës shqiptare, që duan të vazhdojnë të luftojnë për kauzën e të përndjekurve politikë, duan të vazhdojnë të luftojnë për kauzën e lëvizjes së dhjetorit. Ndihen të frustruar – po kaloj te pyetja e dytë – të frustruar se si partitë e së djathtës drejtohen dhe menaxhohen sot nga funksionarë të sistemit të kaluar. E kuptoj, e mirëkuptoj këtë frustracion.

Të bësh ligje antikushtetuese nuk është një mënyrë se si mund të ndihmohen. Unë besoj se ne mund ta ndihmojmë shoqërinë vetëm duke bërë ligje kushtetuese. Dhe, të bëjmë një cirk ku ne harxhojmë kohën e taksapaguesit, qoftë edhe në parlament, për të prodhuar një proces tjetër që, pas disa muajsh rrëzohet nga Gjykata Kushtetuese, besoj se bëjmë një tallje publike, për të cilën shqiptarët kanë pasur përvoja të hidhura njëzet e pesë vitet e fundit. Unë gjykoj se, ku ka vullnet, partitë politike apo cilido grup që beson te transparenca, mund të

ndihmohet edhe me këtë ligj. Ama, t'u kërkojsh njerëzve ndërprerje të mandateve, përjashtime nga puna, dhe të luftosh me mjete komuniste komunizmin, unë besoj se është një oksimoron, një si lojë fjalësh, ku besoj se nuk luftohet komunizmi me mjete komuniste. Komunizmi luftohet me mjete demokratike. Mjet demokratik është transparenca, përvojë e suksesshme nuk na rezulton përvoja lindore. Nuk dua të përmend këtu vende të tjera, por në vendet lindore, qoftë edhe të Ballkanit, që sot janë vende të Bashkimit Europian, ligje ose shartime ligjesh me elemente të tilla kanë shërbyer vetëm për vendeta e hakmarrje politike, për eliminim politik kundërshtarësh, për përjashtim nga drejtësia të funksionarëve që janë përfshirë në procese të rëndësishme dhe për larje hesapesh të politikës së momentit. Nuk kemi asnjë lidhje me një përvojë të tillë. Boll jemi në një klub me Rusinë. Unë besoj se na nderon më mirë të jemi në një klub me Gjermaninë, dhe t'i qëndrojmë besnik një modeli që koha e provoi që funksionon. Sa do të zgjasë kjo periudhë? Thashë, limitet vërtet janë 5 vjet për të drejtën e institucioneve për t'u informuar. Institucionet që emërojnë, pyesin direkt, kurse kandidatët kanë të drejtën të marrin informacionin ose grupimi i tyre politik për kandidatët që duhet të promovojnë.

Nga ana tjetër duhet të përgatitemi për një proces të gjatë, por edhe një proces të kushtueshëm. Ju kujtoj që në Gjermani ka 20 vjet që vazhdon procesi, nga 800 mijë kërkesa, janë procesuar 400 mijë. Pra, është një proces që merr kohë, nëse bëhet në mënyrë profesionale. Besoj se edhe me aq sa është bërë në këtë proces, ka pasur një efekt të jashtëzakonshëm për shoqërinë. Besoj se për ne është e rëndësishme të fillojmë, pastaj të gjithë kohën e nevojshme që do të marrë apo fondet që do të kërkojë dixhitalizimi, profesionalizimi i arkivës, të jemi të gatshëm që t'i përballojmë gradualisht.

Kështu që nuk bëhet fjalë për të larë hesapet e një dite, bëhet fjalë për të projektuar shoqërinë që duam në 10-20-30-40 vjetët e ardhshëm, dhe, kur të mos jemi ne, fëmijët tanë do ta kuptojnë që ky ishte një vit historik, ku bëmë një ballafaqim dhe ndarje nga e kaluara, për të siguruar që brezat e tjerë nuk bëjnë gabimet që mund të kenë bërë brezat e kaluar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje tjetër? Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ju falënderoj për prezantimin dhe materialet sqaruese që na keni vënë në dosje, njëkohësisht edhe për kujdesin që keni treguar për të mos cenuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, opinionin e Komisionit të Venecias dhe për të mos rënë në gabimet e trionismave ligjore që kanë ekzistuar që nga viti 1995 e në vazhdim.

Pyetja ime ka të bëjë me fatin e funksionimit ose të të drejtës që kanë personat për të përdorur dokumente për qëllim të verifikimit të funksionarëve të lartë, sepse i gjithë diskutimi, debati apo ndjeshmëria e publikut është te kjo pikë.

Ju keni thënë që autoriteti vë në dispozicion dokumentacionin dhe lejon përdorimin e tyre për kategoritë e personave që janë funksionarë të lartë deri në 31 mars të vitit 2020. A keni ndonjë arsye ose a ka ndonjë praktikë? E para.

Dhe e dyta, ju me të drejtë parashtroini që ky ligj duhet të tregojë kujdes për të drejtën e ruajtjes së sekretit shtetëror, të mos cenimit të të dhënave personale, për kujdesin që personat të rehabilitohen. Mua më ra në sy gjatë leximit të këtij ligji që një pjesë e mirë e dokumenteve ose mjeteve të ish- sigurimit të shtetit nuk do të jenë të aksesueshme, në qoftë se e kam kuptuar saktë atë. Ju e keni përmendur që për një kategori dokumentesh nuk lejohet të shkosh tek ato mjete, siç mund të jenë filma, dosje e të tjera. Në dijeninë tuaj, gjatë përgatitjes së këtij projektligji, a janë të gjitha dosjet e ish-sigurimit të shtetit, a ka të dhëna? Rimarr pyetjen që bëri kolegu Subashi, a ka të dhëna? A ekzistojnë dublikatat e tyre apo janë selektuar? Si do të veprohet në rast se personat kanë një kërkesë, duan të dinë nëse Sigurimi i Shtetit u ka bërë dosje, a janë përndjekur, a janë prekur dhe nuk ka dosje për këto të dhëna?

Faleminderit!

Erion Veliaj – Shumë shkurt, pastaj po ia kaloj fjalën Gentës.

Së pari, duhet të jemi shumë të qartë, ky ligj nuk ka ndërprerje të mandateve. Pra, ky nuk ka efekt prapaveprues. Ky ligj fillon sot, hyn në fuqi sot, pra kur të kalojë, dhe të gjitha efektet i ka në vazhdim. Arsyeja se ka një limit 5 vjeçar është se ka qenë një rekomandim eksplisit i Komisionit të Venecias, pra nuk mund të ketë efekte pambarimisht edhe për çështje të kohës biologjike të njerëzve. Jemi 25 vjet pas rënies së komunizmit. Pra, pas 5 vjetësh do të flasim për njerëz që janë 30-40 vjeç dhe nuk e kanë provuar kurrë komunizmin. Kështu që në këtë sens, besoj se edhe Komisioni i Venecias ka marrë parasysh përkohshmërinë e këtij procesi.

Kurse për efektet e dosjeve, unë e kuptoj që ka një oreks shumë të madh që të kthehet kjo në një kulturë tabloide. Ky ligj siguron që misioni i këtij autoriteti nuk është që të mbushë faqet e para të gazetave, përkundrazi është shumë i qartë në mbrojtjen e të dhënave personale, ashtu siç ju mund ta keni parë edhe në dokumentarin që ilustronte siç ndodhte në Gjermani. Të dhënat për personat e tretë, pra jo për personat e prekur, fshihen, pra ka një respekt rigoroz për privatësinë e njerëzve.

Nga ana tjetër, besoj që edhe për çështjen e arkivave, është një mit urban që nuk ekziston. Problemi është që për sa kohë nuk i hapim dosjet, nuk do të zbulojmë kurrë se

ekzistojnë. Pjesa më e madhe e atyre që duan të përdorin arkivën, bëhet fjalë, për shembull, për disa mijëra të zhdukur, ka shumë njerëz që kërkojnë për prindërit e tyre ose për gjyshërit e tyre se ku janë ekzekutuar ose ku janë varrosur dhe gjëra që janë shumë më njerëzore sesa politike.

Besoj se misioni i vërtetë i këtij ligji është një mision human dhe social sesa një mision politik që politikanët të lajnë hesapet apo gazetatat të mbushin faqet e para me tabloide. Dhe për këtë duhet të jemi shumë të qartë dhe ligji ka specifikime shumë korrekte.

Gentiana Sula – Diçka shkurt. Ne, gjatë hartimit të ligjit, filluam edhe me një inventar të sasisë së dosjeve, që aktualisht disponojnë institucionet shtetërore, qoftë Ministria e Brendshme, qoftë SHISH-i. Të dyja institucionet bënë një inventar dhe e paraqitën në tryezën që ne organizuam për këtë qëllim. Me sa duket, ka pasur momente të historisë sonë të tranzicionit që ka pasur edhe shkatërrim, qoftë me qëllim apo pa qëllim në momente anarkie, megjithatë një pjesë e mirë e dosjeve janë aty, dhe, siç e tha ministri, na duhet t'i hapim e të shohim se sa të dobishme apo të përdorshme do të jenë. E rëndësishme është që një pjesë e mirë është të paktën. Nga inventari, ministri e përmendi, rreth 12 mijë dosje janë aktualisht, rreth 1 milion e gjysmë faqe, kështu që ka një material të bollshëm.

Dhe, nëse ka një arsye më shumë që ky ligj të kalojë dhe të hyjë në fuqi menjëherë, është pikërisht të ruajmë keqpërdorimin e këtyre dosjeve që kanë mbetur tashmë të pahapura.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera?

Kam unë tri pyetje edhe në funksion të debatit që do të bëhet në parim dhe pastaj edhe nen për nen.

Zoti Ministër, bëhet fjalë për një proces që duhej të ishte bërë 25 vjet përpara. Ju kam dëgjuar ju nëpër medie, kam dëgjuar shumë njerëz që flasin për këtë gjë, kam ndjekur edhe emisionin që cituat ju në njërin nga televizionet kombëtare, por gjëja e parë që është thënë në të gjitha këto raste, edhe në modelin që ju i referoheni, është se ky model nuk nis sot, ka nisur 25 vjet më parë.

25 vjet më pas edhe nga një këndvështrim, sepse nuk dua t'i hyj nga një këndvështrim i disa standarde të Këshillit të Europës, të Komisionit të Venecias për këtë çështje, sepse besoj se kjo do të jetë një çështje diskutimi këtu, social, qytetarët shqiptarë 25 vjet më pas, ky është problemi themelor që kanë, kjo është çështja që i prekupon ata që t'u japim këtë ligj? Cili është interesi i veçantë publik në këndvështrimin tuaj që 25 vjet më pas t'i kthehemi kësaj çështjeje?

Kam edhe një çështje të dytë që dua të trajtoj dhe për këtë më ndihmoi pak edhe zonja zëvendësministre me përgjigjen që dha. Kam një pyetje që është normale, sa realist dhe sa i vërtetë është ky proces në kushtet e trajtimit shqiptar të dokumentacionit? Sepse jo vetëm që kanë kaluar 25 vjet, por për 25 vjet ky dokumentacion është trajtuar në mënyrën më amatoreske, për të mos thënë që është deformuar, ka zëra, por unë nuk jam personi që mund ta them. Kështu thuhet, ju jeni në gjendje ta thoni më mirë ose ata që do të vijnë këtu? Në këto kushte, në këto rrethana sa realist, sa objektiv mund të jetë ky proces? Sepse objektiviteti është thelbi i një procesi të tillë.

E treta, cila është kostoja financiare e këtij procesi? Unë ju dëgjova ju se nuk e kisha këtë gjë në mendje, me thënë të drejtën, ju thatë përgatituni se do të jetë një proces. Thashë midis të tjerave që po na përgatit shpirtërisht ministri, të paktën financiarisht. Ne të varfër jemi, të pyesim një herë ka kosto kjo, se shpirtat janë trazuar shumë në këtë vend, po financiarisht a ka kosto?

Zoti Ministër, ju lutem.

Erion Veliaj – Faleminderit, zoti kryetar për pyetjet, sepse prekin thelbin e këtij ligji!

Pyetja e parë është (besoj që është një pyetje, që e bëjnë shumë qytetarë), a është kjo çështja më e rëndësishme që prek sot Shqipërinë? Nuk e di nëse është më e rëndësishmja, por di që është e rëndësishme për disa arsye:

Së pari, ne si ministri kemi pasur me kërkesë të qeverisë pesë fusha kryesore ku na është dashur të bëjmë reforma të mëdha: pensionet; reforma e arsimit profesional; reforma në tregun e punës, me zyrat e punës; reforma e çështjes sociale, pagesat e aftësisë së kufizuar dhe e asistencës sociale, ndihmës ekonomike dhe reforma e ish- të përndjekurve.

Kështu që, si menaxher i këtij ekipi, kam pasur një listë prioritetesh, ku katër reformat e para tashmë janë bërë. Reforma e pensioneve ka hyrë në fuqi. Vitin e kaluar ne patëm 93 mijë e 392 të siguruar më shumë. Askush nuk është naiv të thotë se këto janë të gjitha vende të reja pune, disa janë dhe disa të tjera janë vende të legalizuara. Historia është që në bordero kemi rreth 100 mijë vetë më shumë në sigurimet shoqërore. Për herë të parë kemi më shumë të siguruar sesa pensionistë dhe kjo na mundëson që të rrisim pensionet.

Unë vetë jam fëmijë ushtaraku. Dje pashë që për herë të parë një ushtarak sot del me pension me 330 mijë lekë, ndërkohë që me skemën e vjetër ishte i kufizuar, edhe pse mund të kishte punuar 40 vjet në ushtri, nën një tavan 240 mijë lekë dhe të hidhej përpjetë, sado vite dhe rroga të kishte në ushtri, nuk ia shpërblenin mundin. Sigurisht, më dha kënaqësinë e faktit që reforma jo vetëm hyri në fuqi, por filloi edhe të japë frytet e para. U rritën financat

publike, çka na mundëson të rrisim pensionet. Këtë vit do të rrisim sërish me 2% pensionet dhe brenda një viti do t'i kemi rritur me 4%, falë performancës së mirë të skemës, që këtë vit, fatmirësisht, prodhoi edhe 100 milionë dollarë më shumë nga kontributet që u mbledhën.

Reforma e dytë ka qenë ajo e arsimit profesional. Gjykoj që rezultati kryesor është se u rrit vajtja në shkollat profesionale, janë 40% më shumë të rinj, dhe besoj se sot jemi në një rrugë të mbarë, ku jo vetëm biznesi po i drejton bordet e shkollat profesionale. Në shtator ne do të kemi 42 drejtorë ndërkombëtarë, kryesisht austriakë, gjermanë, zviceranë, izraelitë dhe amerikanë në shkollat profesionale. Pra, besoj se jemi në rrugën e duhur dhe për këtë reformë dhe unë mendoj se ka nisur mbarë dhe po ecën.

Reforma e tretë ishte ajo e tregut të punës. Sërish punuam me një model gjerman, “Arbajt Agenturë”, e që është e famshme për mënyrën sesi ka menaxhuar tregun e punës, që i shpëtoi krizës në Gjermani, ndihmoi në modernizimin e tregut tonë të punës dhe të zyrave të punës që kanë pasur një efekt. Edhe këtë e konsideroj një reformë, për të cilën ky komision dhe komisionet e tjera janë shprehur dhe e konsiderojnë të suksesshëm.

Reforma e katërt, ajo që ka qenë më sensitive, është reforma e ndihmës ekonomike dhe e aftësisë së kufizuar. Mbani mend që kur kemi ardhur në këtë parlament të nderuar, si maxhorancë, në 2013-n, ishin ndërprerë të gjitha pagesat. Falë reformës, e kuptoj që edhe parlamenti u vu nën presion me disa protesta, ja ku jemi sot, që jo vetëm u paguan në kohë, por u dha edhe shpërblim pas 8 vjetësh, gjë që nuk jepej jo më për punonjësit, por as për pensionistët, ish- të përndjekurit dhe për personat me aftësi të kufizuara. Kështu që në listën e detyrave të shtëpisë, që unë kisha si menaxher i këtij ekipi dhe të kësaj ministrie për këto pesë detyra, katër të parat i kam konsideruar me prioritet dhe i kemi trajtuar.

Detyra e pestë ka qenë çështja e ish- të përndjekurve politikë, që e kemi ndarë në dy komponentë: çështja e ligjit të transparencës së dosjeve dhe çështja e kompensimit financiar.

Besoj se te çështja e dytë kemi ecur më shumë. Ky komision i nderuar dhe parlamenti shqiptar me ligjin e ri na mundësuan që ne të shpërblejmë ata që sot janë gjallë dhe ata që janë me më prioritet që t'i kenë paratë për t'i jetuar me dinjitet ditët e fundit të jetës së tyre sesa nipërit dhe mbesat, që janë në moshën 20 ose 30-vjeçare dhe shumë mirë mund të jenë pjesë e këtij tregu të punës, se dikush që është 80-90 vjeç dhe kishte ngelur te kësti i dytë.

Qeveria jonë e majtë, socialiste, duhet të ndihet krenare që në 1 vit ka dhënë 4 -5 këste, ndërkohë që në 8 vjet ishte dhënë vetëm 1 këst. Bilali sot, jo vetëm si drejtor i ish-të përndjekurve, por si përfaqësues i shtresës, i lindur dhe rritur në internim, është dëshmitar që ministria jonë, shteti ynë dhe qeveria jonë i ka më të përfaqësuar ish-të përndjekurit nga

Genta, nga Bilali dhe shumë drejtues të tjerë që ndjekin këto çështje. Ne kemi qenë të zhdërvjellët dhe shumë eficientë me menaxhimin e fondeve.

Ju kujtoj që edhe kur ka pasur fonde, njëherë ka pasur fonde më të larta se ç'jep qeveria e majtë, ka qenë kohë fushate, nuk shpenzoheshin dot dhe digjeshin. Kështu që në prill ne do të fillojmë dhënien e kështit tonë të 5-të dhe besoj që me gjysmën e fondit tonë të 5-të ne jemi në rregull me financat për ish- të përndjekurit.

Pjesa e fundit që na ka mbetur në këtë listë me pesë reforma ka qenë pikërisht kjo. Kështu që jam dakord me ju, mund të ketë çështje të tjera që mund të jenë më të rëndësishme, por kjo është një kërkesë konstante e këtij grupi. Një ministri që katër gjërat e para i ka kaluar në këtë parlament dhe e ka respektuar këta me prioritet është sot te detyra e pestë dhe e fundit, që kishte në këtë mandat të parë për të realizuar dhe besoj se duhet t'i qëndrojmë besnik me të njëjtën besnikëri dhe zell, si katër reformave të tjera, edhe kësaj, që është në gjysmë të rrugës dhe meritonte gjysmën tjetër të transparencës. Ju kujtoj që ka qenë dhe një kërkesë e Komitetit Ndërkombëtar, ka një rezolutë të Këshillit të Europës, kemi pasur disa rekomandime të progres-raportit të Komisionit European, dhe ajo që thamë edhe në fillim, nuk besoj se na nderon, me gjithë respektin për Rusinë, por nuk na nderon të jemi dy vende që citohemi si një klub më vete, kur vjen puna te fshehtësia dhe mungesa e transparencës, se besoj që edhe politikisht është në interes të Republikës së Shqipërisë të jetë në familjen e kombeve që besojnë tek transparenca dhe largohen drejt një modeli lindor të fshehtësisë.

Për çështjen e objektivitetit, çfarë është bërë me dosjet dhe sa integritet ka ky informacion ose arkivat e mbetura?

Në hulumtimin tonë, në Gjermani, në fakt, gjendja ishte më dramatike. Në ditët e fundit, Stasi, dogji, grisi dhe asgjësoi një pjesë të mirë të informacionit, dhe duhet të them që institucionet gjermane filluan vetëm me 50 % të bazës materiale, dhe imagjino, me 50 %, dhe ende janë në gjysmë të rrugës të një procesi transparent, ku kanë shqyrtuar vetëm gjysmën e kërkesave. Unë besoj që shumë prej materialeve kanë lidhje me njëra-tjetrën, vërtet mund të ketë dosje që mund të jenë zhdukur në përmasa shumë më të vogla sesa në rastin e Gjermanisë, por unë them që e vetmja mënyrë për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje është duke i hapur dosjet dhe duke parë çfarë kemi në këtë arkiv dhe me çfarë mund të punohet për sa kohë që i qëndrojmë besnik këtij procesi.

Unë besoj se kjo përgjigje adreson dhe shqetësimin tuaj shumë real, që dosjet janë përdorur kaq kohë për shantazh. A po e inkurajojmë ne këtë shantazh? Unë besoj se kjo i jep fund shantazhit. Dhe pikërisht për faktin që dosjet nuk hapeshin, ne kemi pasur ish-

kryeministra që thoshin: “Unë kam dosje për ty”, “Unë të kam ty këtë gjë” dhe në pjesën më të madhe ky ishte një shantazh i hapur. Dhe e vetmja mënyrë për të hequr këtë kulturë të ndyrë, si ajo që dëgjuam ndoshta edhe sot në fillim të seancës, ku njerëzit për të cilët filloi dekriminalizimi, ishin sot avokatët më të mëdhenj kundër dekriminalizimit, e paimagjinueshme. Njeriu që sot bërtiste më shumë në këtë seancë, ishte se bënë çmos për të dekriminalizimit.

Kështu që, për t’u larguar nga kjo politikë qesharake, vetëdiskredituese dhe shantazhuese, unë besoj që transparenca, për aq sa janë, që janë gjithsesi më shumë në përqindje sesa në Gjermani, besoj se është e dobishme.

Ne kemi llogaritur në relacion, për pyetjen tuaj të tretë, një shpenzim prej 30 milionë lekësh të reja për ngritjen e institucionit, duke parashikuar që nuk është një shumë e vogël, por gjithsesi, krahasuar me shumat që xheston ministria jonë, kur vjen puna në të gjitha fushat e tjera, sidomos te pagesa e të përndjekurve politikë, është një fraksion jashtëzakonisht i vogël, dhe nëse ne do të kemi dakordësinë e Ministrisë së Financave, fundja mund të dalë edhe nga ai buxhet, sepse shuma realisht nuk është aq prohibitive për të operuar këtë proces.

Megjithatë, kur vjen puna tek teknologjia që do të përdoret, te futja e sistemeve dixhitale, gjykoj që do të jetë më adapt që ne të aplikojmë në fonde të Bashkimit Europian. Vende si Gjermania janë ofruar të na mbështesin edhe financiarisht, nëse do të lindë nevoja, dhe besoj që ajo që ne kemi kërkuar, është vetëm një fond operacional dhe pastaj pjesën tjetër të asaj që e quajmë investime dhe modernizime të infrastrukturës, ne do të ishim të përgatitur që të aksesojmë disa fonde, ku ministria tashmë është bërë anëtare dhe ka paguar faturën, ashtu siç kemi bërë me ERASMUS, kemi bërë me *Europe for Citizens* dhe me fonde që investojnë institucionet e memories kolektive dhe të kujtesës. Kështu që, do të tregohemi të zhdërvjellët për të marrë nga këto burime dhe për të mos prekur më shumë buxhetin e shtetit në kushte të një disipline fiskale që po aplikohet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Nuk besoj se ka pyetje të tjera. Mbyllën me këto.

E mbyllim këtu këtë seancë.

Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Faleminderit, zonja drejtoreshë!

Zoti drejtor i kabinetit, nuk e ndërpreva ministrin, e pashë që nuk duhet ta ndërprisja, sipas porosisë suaj.

Zoti Kola, faleminderit, që ishit këtu!

Faleminderit, kolegë deputetë!

Takohemi nesër në seancë plenare.

Erion Veliaj - Shumë faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET